

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9918 , DATË 19.5.2008, “PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Hartimi i këtij projektligji është diktuar nga nevoja për të reflektuar ndryshimet e propozuara në ligjin nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me rregullimin e shërbimeve të publikimeve elektronike, për shkak të rritjes së impaktit të tyre në aspektin social, kulturor, ekonomik dhe politik të shoqërisë shqiptare, një fenomen që haset gjerësisht edhe në vendet e tjera.

Mediat elektronike (*on-line*) janë një trend në rritje, të cilat po shmangin dhe po zëvendësojnë mediat tradicionale, për shkak edhe të lehtësisë së aksesit së çdo individ dhe përdorimit të portaleve *on-line* nga një numër i pakufizuar personash.

Prandaj, për të mbrojtur veçanërisht dinjitetin dhe reputacionin e individit, të miturit nga përmbajtjet e dëmshme dhe të gjithë qytetarët nga nxitja ndaj urrejtjes, dhunës etj. propozohet amendimi i këtij ligji, si një nismë e domosdoshme mbështetëse për zbatimin efikas të ligjit për mediat audiovizive, i cila parashikohet të përfshijë në objektin e tij edhe rregullimin e mediave elektronike.

Ndryshimet e shpejta që po ndodhin në shoqëri, si në fushën e teknologjisë, shkencës, ekonomisë dhe kështu me radhë, kanë ndikim edhe në krijimin e normave të reja ligjore që nuk janë parashikuar më parë. Në momentin e miratimit të ligjit për komunikimet elektronike në vitin 2008, roli i teknologjisë dhe internetit në përhapjen e informacionit nuk ishte në dimensionet që ka arritur sot informimi nëpërmjet portaleve *on-line*. Në këto kushte, duke mbajtur në fokus veçanërisht influencën e portaleve *on-line*, gjatë viteve të fundit është e nevojshme që të ndërmerret kjo nismë me qëllim që zhvillimet teknologjike sociale etj të ecin paralelisht me evoluimin e kuadrit ligjor.

Gjithashtu, vlen të theksohet që pavarësisht nga ndryshimet e propozuara, ky projektligj në asnjë dispozitë të tij nuk cenon lirinë e shprehjes dhe pluralizmin

e tregut të medias audiovizive dhe elektronike, por synon përcaktimin e disa rregullave dhe vendosjen e disa standardeve etike në mënyrë që të respektohen dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe e diskursit publik.

II. VLERËSIM I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA

Projektligji nuk është përfshirë në programin analitik të akteve, por është në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare për garantimin dhe mbrojtjen e dinjitetit e të drejtave themelore të njeriut, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Një sistem mediatik konsiderohet si pluralist nëse pushteti i medias nuk është i përqendruar në terma të pronësisë, strukturës ekonomike dhe influencës politike. Nëse media është e lidhur ngushtë me fuqinë ekonomike ose politike, atëherë cenohet roli i saj si vëzhgues dhe shpërndarës i informacioneve objektive. Edhe në vendet e BE-së konstatohet se përqendrimi i pronësisë së mediave në pak pronarë është agravuar për shkak të pronësisë ndërsektoriale dhe përfshirjes së elitave politike. Kështu, edhe në BE, fuqia komunikuese politike dhe ekonomike e medias është përqendruar në pak duar, duke cenuar pluralitetin në përmbajtje të lajmeve apo opinioneve. Konstatohet se oligarkët e përdorin median si fuqinë e tyre komunikuese për të mbështetur interesa të caktuara politike, ekonomike ose sociale. Teknologjia digjitale e ka transformuar tregun e medias, sidomos për sa i përket financimit, shpërndarjes dhe konsumit. Kjo mund të rezultojë në zvogëlim të diversitetit të përmbajtjes së informacionit që konsumohet nga qytetarët

Në Shqipëri është e nevojshme marrja e masave për regjistrimin e portaleve/*online* të medias për tri arsye kryesore:

- a) Regjistrimi i portaleve dhe medias i shërben transparencës mbi pronarët e mediave, shmangies së konfliktit të interesave, ndikimit të papërshtatshëm mbi median të aktorëve politikë ose ekonomikë, garantimin e pavarësisë së medias si dhe pluralizmit të medias.
- b) Nëpërmjet regjistrimit mund të mbikëqyret nëse media është e përqendruar në duart e një apo dy-tre pronarëve, çka do të cenonte pluralitetin e medias

në përmbajtje. Përqendrimi i medias në duart e pak pronarëve cenon parimin e pluralitet të medias.

- c) Ka gazetarë të punësuar në portalet *on-line*, të cilët nuk kanë kontratë as mbrojtje sociale (sigurime shoqërore, shëndetësore). Është e nevojshme që punësimi i këtyre personave të jetë në përputhje me legjislacionin e punës dhe mbrojtjes sociale në fuqi, si edhe me Kartën Evropiane Sociale, edhe pse këta gazetarë punësohen nga kompani të vogla apo persona fizikë, apo nuk kanë kontrata standarde/ me kohë të plotë.

Një ndërhyrje ligjore për t'iu përgjigjur këtyre nevojave është në përputhje edhe me tendencat më të fundit të institucioneve të Bashkimit Evropian. Këto rekomandime i gjejmë edhe në Raportin e Parlamentit Evropian për shtetet anëtare të BE-së. Rekomandimi 3(1): Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizuale duhet të amendohet dhe t'u kërkojë shteteve anëtare të sigurojnë lirinë dhe pluralizmin e tregut të medias audiovizuale, duke vendosur rregulla të përshtatshme për të luftuar përqendrimin e tregut të medias. Rekomandimi 4:

Në kuadër të Direktivës për Shërbimet e Medias Audiovizuale, duhet të ngrihet një *database* që të përmbajë informacion për të gjithë pronarët e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të mediave, e cila do të mbahet nga Platforma Evropiane për Autoritetet Rregullatore ose Komisioni Evropian. Shtetet anëtare duhet të marrin masa që pronësia e kompanive mediatike të regjistrohet në *database*.

Sugjerohet rishikimi i Direktivës së Transparencës në BE me qëllim që këto parashikime të përfshijnë si median e shkruar ashtu edhe atë *on-line*.

Sikundër media tradicionale edhe media *on-line* mund të regjistrohet sipas ligjit për shoqëritë tregtare (nëse kryejnë aktivitet ekonomik) ose nga ligji për OJF-të (në rast se jofitimprurëse).

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë studiuar legjislacionet dhe modelet e shteteve të tjera të Bashkimit Evropian. P.sh. në Letoni media do të regjistrohet në Regjistrin e Shoqërive Tregtare. Kroacia: neni 5 i “*The electronic Media Act*” në regjistrin pranë gjykatës ose në regjistra të tjerë në Kroaci. Në Francë: shërbimet vendase mediatike audiovizive (AVMS) mund të regjistrohen ose si shoqata nëse nuk janë fitimprurëse (association sans but lucratif) ose si shoqëri tregtare që kanë objektiva sociale (société à finalité sociale).

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës dhe është në përputhje me parimet kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi, duke siguruar respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut si dhe garantimin e lirisë së shprehjes.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE

Projektligji është në përputhje me praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 5 nene.

Në nenin 1 jepen përkufizimet: “ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike” dhe “publikime elektronike”, të cilat kanë të njëjtin kuptim sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.

në kuptim të këtij ligji, terma këto që kanë lidhje të qenësishme me përmbajtjen e projektaktit, të cilat ndihmojnë për shmangien e keqinterpretimeve gjatë zbatimit të ligjit në praktikë.

Në nenin 2 shtohen kompetencat e AKEP-it në mënyrë që të formalizohet qëllimi i kësaj nisme.

Në nenin 3 shtohet një pikë mbi nevojën për bashkëpunim ndërmjet AKEP-it dhe AMA-s, propozim ky që vjen si pasojë edhe e ndryshimeve të propozuara në ligjin për AMA-n.

Në nenin 4 propozohet shtimi i sanksionit me gjobë në rastet kur ofruesit e shërbimit të komunikimeve publike nuk zbatojnë urdhrat/vendimet e AKEP-it që lidhen me zbatimin e akteve/vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe të AMA-s apo të nxjerra nga çdo organ tjetër me kompetenca ligjore në këtë fushë, sipas nenit 4, të këtij ligji.

Në nenin 5 parashikohet hyrja në fuqi e tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AMA dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VIII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës, me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë e të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe ekspertë të fushës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk përcjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE